



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 6 dhjetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Ardian Gjini, Mufera Şinik, Arsim Bajrami, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivkoviç.

Munguan: Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu dhe Haki Demolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: David Greer – USAID, Sefadin Blakaj – USAID, Ukshin.....- USAID, Naim Hajdari – EULEX, Sanije Berisha – OSBE, Fatos Qerimi – student, Norie Nikolla – Bota Sot, Natyra Krasniqi – KDI, Florie Mehmeti – KDI dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.10.2011;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L- 54 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve , pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave;
5. Njoftimi i Komisionit me raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim në Projektligjin për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr. 04/952/L-61;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për rregullimin e tokës nr. 04/664/L-40/1;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për shërbime këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/1179/L-74;

9. Formimi i grupit të punës, propozimi i ekspertëve dhe caktimi i datës për dëgjimin publik për shqyrtimin e Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve;
10. Njoftimi i Komisionit me përgjigjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit sipas kërkesës të datës 16 nëntor 2011;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e katërt të hiqet nga rendi ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.10.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes 10.10.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L- 54 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre

Kryetari - Paraqiti vërejtje në preambulën e Projektligjit, tek pasuesi i dytë, i cili propozoi që të fshihet si dhe tek dispozitat e hyrjes në fuqi në nenin 27 propozoi këtë formulim: “Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.

Arsim Bajrami - U pajtua me vërejtjet e paraqitura nga kryetari, mirëpo insistoi që ligji të shkojë në procedure të miratimit.

Armend Zemaj- U pajtua me parafolësit për dy vërejtjet e ngritura, por shtoi edhe një vërejtje në amendamentin 17 ku shtohet një paragraf: „Ish- Ministrisë së Mbrojtjes”, ai shprehu mendimin se duhet t’i shtohet edhe “së Republikës së Kosovës”, mos të mbetet vetëm ish- ministri e mbrojtjes, sepse nuk është në përkufizime si sqarim dhe mund të shkaktojë keqkuptime, ose të përfshihet në përkufizime çka nënkupton „Ish- Ministri e Mbrojtjes”.

Arsim Bajrami- Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit, tha se në fakt përdorimi i termit ish-ministri e mbrojtjes, asocion qartë në Ministrinë e Republikës së Kosovës, mos ta bëjmë problem për një gjë shumë formale.

Armend Zemaj- Tek terminologjia ku është ish- ministria e mbrojtjes, duhet të ceket ish- Ministria e Mbrojtjes së Kosovës, dihet edhe periudha edhe koha, dhe nuk paraqet diçka të paqartë, ka të bëjë vetëm me formimin e komisionit, i cili verifikon statusin e dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të luftës, nuk mendoj që e ngarkon atë pjesën politike.

Arsim Bajrami- Theksoi se si Komision mund të japim si rekomandim që në kaptinën ku janë përkufizimet, Komisioni i ligjeve propozon që kjo të zërthehet dhe nuk ka nevojë mandej edhe në ligj.

Kryetari- Kjo është e qartë atëherë, ne kërkojmë që tek përkufizimet të sqarohet se çka është “- ish Ministria e Mbrojtjes” dhe konstatojmë në emër të Komisionit për procesverbal se ish- Ministria e Mbrojtjes i referohet ministrisë në periudhën e cila ka ekzistuar atëherë nga periudha kohore kur është themeluar deri në vitin 1999 kur është shuar.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L- 54 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përveç pasuesit të dytë.
2. Komisioni sugjeron që pasuesi i dytë i preambulës “ **Duke pasur parasysh Rezolutën e Kuvendit të Kosovës, të nxjerrë më datën 15 maj 2003, për Luftën Çlirimtare të Popullit të Kosovës për Liri dhe Pavarësi**” të hiqet sepse rezoluta nuk paraqet bazë juridike për nxjerrjen e ligjit.
3. Komisioni po ashtu sugjeron që neni 27 i Projektligjit që ka të bëjë me hyrjen në fuqi të riformulohet si vijon: “**Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës**”.
4. Komisioni sugjeron që në përkufizime të përfshihet edhe nocioni “**Ish- Ministri e Mbrojtjes**” sepse lë hapësirë për interpretim, pasi që ky nocion është përfshirë në amendamentin 17 të Komisionit Funkcional.
5. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
6. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit, me sugjerimet e Komisionit për Legjislacion.

4. Njoftimi i Komisionit me raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim në Projektligjin për Shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore nr. 04/952/L-61

Komisioni e shqyrtoi për herë të dytë raportin me amendamente në Projektligjin për shitjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore nr. 04/952/L-61, dhe konstatoi se është e panevojshme që të shqyrtohen edhe një herë të njëjtat amendamente, për të cilat është deklaruar në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2011.

Lidhur me ekspertizën e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, vlerësoi se nuk është në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion shqyrtimi i analizës, sepse kjo është në fushëveprimin e Komisionit Funkcional.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Rregullimin e tokës nr. 04/664/L-40/1

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin për rregullimin e tokës dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/664/L-40/1 për rregullimin e tokës, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për shërbime këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/1179/L-74

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për shërbime këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/1179/L-74 për shërbime këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Formimi i grupit të punës, propozimi i ekspertëve dhe caktimi i datës për dëgjimin publik për shqyrtimin e Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

Arsim Bajrami - Propozoi që sa më parë të fillohet puna për shqyrtimin e këtij Projektligji, dhe lidhur me këtë si ekspertë propozoi: Nerxhivane Dautin, Iset Morinën, Sefadin Blakajn dhe Adem Vokshin.

Kryetari- Propozoi që fillimisht të formohet një grup i punës dhe ky grup ta drejtojë punën për shqyrtimin e këtij Projektligji.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje nxori këtë

PËRFUNDIM

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve në këtë përbërje:

- Arben Gashi, kryesues;
- Ardian Gjini, anëtar;
- Albulena Haxhiu, anëtare;
- Arsim Bajrami, anëtar;
- Amir Ahmeti, anëtar;
- Jasmina Zhivković, anëtare.

9. Njoftimi i Komisionit me përgjigjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit sipas kërkesës të datës 16 nëntor 2011

Kryetari - Theksoi se në përgjigjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, sipas kërkesës të datës 16 nëntor 2011, Agjencia Kundër Korrupsionit ka paraqitur raport, e që unë kam vërejtur disa probleme thelbësore, për të cilat mendoj që duhet të thirret drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit. Ai e njoftoi Komisionin me përmbajtjen e raportit ku ndër çështje të tjera në raport janë përfshirë edhe formularët e deklarimit të pasurisë ku kemi një mospërputhje dhe mund të vlerësohet si konflikt interesi, andaj vlerësoi se duhet të ftohet në një takim të radhës së Komisionit drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Për këtë pik diskutuan edhe Ardian Gjini, Arsim Bajrami dhe Armend Zemaj dhe ishte vlerësim i përgjithshëm që të ftohet drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit në një takim të radhës së Komisionit.

10. Të ndryshme

a U formua grupi i punës për Projektkodin penal të Republikës së Kosovës në këtë përbërje:

- Behar Selimi, kryesues;
- Armend Zemaj, anëtar;
- Halit Krasniqi, anëtar;
- Ardian Gjini, anëtar;
- Haki Demolli, anëtar dhe
- Mufera Sinik, anëtare.

b. Kryetari, I njoftoi anëtarët me raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa i cili ka paraqitur vërejtje neni 15 të Projektligjit dhe ka sugjeruar që fjala “ Njësi “ të hiqet sepse dyshohet që mund të shkaktojë implikime financiare. Ai kërkoi që të përkrahet kjo vërejtje dhe si Komisionin Funkcional të hartojmë edhe një amendament me të cilin do ta fshijmë (ta heqim) fjalën “ Njësi “ tek ky nen.

Propozimi u përkrah nga anëtarët e Komisionit që të hartohet amendament në përputhje me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi